URDHËR
Nr. 98, datë 23.2.2024

PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME PRODHIMIN E *CANNABIS*-it PËR QËLLIME MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar dhe të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale",

URDHËROJ:

1. Licenca, për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore është sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

LICENCË

Nr. _____, datë _____

PËR USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME PRODHIMIN E *CANNABIS*-it PËR QËLLIME MJEKËSORE

Në mbështetje të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" dhe vendimit të Komisionit të Licencave nr. _____, datë_____.

I JEPET

SUBJEKTIT: _____,

ADRESA: _____,

AFATI: _____,

ZONA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT: _____,

PËR VEPRIMTARITË E MËPOSHTME:

- kultivimin, prodhimin e bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore;
- transportimin e farërave, bimëve dhe produkteve e nënprodukteve të *cannabis*-it për qëllime mjekësore në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- eksportin e bimëve, produkteve dhe nënprodukteve të *cannabis*-it për qëllime mjekësore.

KUSHTET E LICENCËS:

Kjo licencë lëshohet në përputhje me ligjin nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Subjekti, në ushtrimin e aktivitetit të tij, vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

MINISTËR

(Emër, Mbiemër)
(Firmë)